



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

01 Nr. 291/12
Më: 30/10/12

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e VIII-të për vitin 2012, e Kuvendit Komunal në
Vushtrri, mbajtur më 27.9.2012

Mbledhja është mbajtur në sallën e kuvendit komunal duke filluar në orën 08:45. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Arta Ismajli, Avdullah Halimi, Bahrije Pllana, Besim Jashari, Ergin Sunguri, Esat Beka, Ferit Idrizi, Gani Imeri, Habib Mustafa, Habibe Gérxhaliu, Hadrulla Muli, Islam Krasniqi, Ismet Gashi, Makfirete Ademi, Merjeme Ismajli, Melihate Basholli, Muharrem Shabani, Naile Osmani, Nysret Gérxhaliu, Pajazit Pllana, Qazim Azemi, Refik Ramaj, Remzije Isufi, Sabit Kadriu, Sabri Ferati, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Shpëtim Zhegrova, Syzana Syla, Tasim Gubetini, Veli Karaça, Vlora Qirezi, Xhemajl Pllana, Xhylsime Feka dhe Zeqir Hasani.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: kryetari i komunës, drejtoret e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Habib Mustafa - kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të LDK-së paraqiti shqetësimin për ndërrimin e planit të punës së kuvendit të komunës lidhur me buxhetin komunal, pasi që në planin e punës së kuvendit është paraparë që me 13 shtator të mbahet seancë e veçantë për përpilimin e dokumentit kryesor të politikës lokale fiskale-buxhetit komunal. Gjithashtu në emër të Grupit parlamentar të LDK-së propozoi që vizita e planifikuar në Shqipëri për anëtarët e kuvendit të realizohet në fillim të muajit nëntor, në vigjilje të kremitimit të 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të AAK-së propozoi që në "të ndryshme" të futet kërkesa për ndihmë për shërim të Shehrije Feratit (bashkëshortes së dëshmorit) nga fshati Sfaraçak.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- propozoi që në "të ndryshme" të futet çështja e eksploatimit të thëngjillit në fshatin Bivolak, pasi që disa fshatarë të fshatit Bivolak janë të shqetësuar për eksploatimin pa kriter të thëngjillit nga 8 kompani.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- tha se Grupi parlamentar i PDK-së e përkrah rendin e ditës, që në "të ndryshme" të futet edhe propozimi AAK-së, kurse lidhur me propozimin e S.Kadriut kërkoi që të shtyhet për seancën tjetër dhe të vjen si material i kompletuar.

Ferit Idrizi, anëtar i kuvendit- e përkrahu qëndrimin e shefit të Grupit parlamentar të PDK-së, kurse lidhur me çështjen e eksploatimit të thëngjillit, propozoi që të përgatitet si pikë e rendit të ditës për seancën e ardhshme.

Xhylsime Feka, anëtare e kuvendit- në emër të grupit të grave asambleiste të kuvendit të komunës paraqiti shqetësimin se në mesin e shumë aktiviteteve tjera, pikërisht me 1 shtator (Ditën e Dëshmorëve) për të vënë kurora në varrezat e dëshmorëve nuk ishte e ftuar asnje femër, dhe në veçantiasnje femër anëtare e kuvendit të komunës, kurse dihet që në mesin e anëtareve të kuvendit ka që kanë humbur më të afërmët e tyre, prandaj në emër të grupit të grave asambleiste reagoi nga këtij gjesti injorant, të pakulturuar të organizatorit e që është Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, pasi që veprimet e tillë janë të patolerueshme, janë një imazh shumë i keq, dhe është ndërgjegje e ulët dhe primitive. Në fund tha se ta respektosh dhe përkrahësh gruan në avancimin e saj, atëherë ke ndihmuar dhe kontribuar në prosperimin e shoqërisë, shtetit dhe institucionit të shenjtë-familjes.

Habib Mustafa, kryesues i kuvendit- paraqiti për votim rendin e ditës ashtu siç është paraparë në ftesë, kurse për "të ndryshme" propozoi që të futet propozimi i AAK-së.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, kuvendi në mënyrë unanime miratoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë, për periudhën janar-qershor 2012.
3. Shqyrtimi i Draft-buxhetit të komunës për vitin 2013, projekteve investuese, si dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore, për periudhën 2013-2015.
4. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, për vitin 2013 (Shqyrtimi i dytë).
5. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e vitit shkollor 2011/2012 dhe përgatitjet për vitin shkollor 2012/2013.
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpalljen e konkursit për anëtarësim në komitetet konsultative.
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve buxhetore të komunës.
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit nr. 39/10, të datës 25.02.2010.
9. Të ndryshme:
 - a. Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë për shërim të Shehrije Feratit;
 - b. Pyetjet eventuale të anëtarëve të kuvendit.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- paraqiti vërejtje tek pika nr. 6 e rendit të ditës, pasi që mungon pjesa e diskutimit të tij, prandaj propozoi që t'i përfshihet kjo fjalë: "pasqyrat financiare te asetet kanë deviacion me dhjetëra milionë euro".

Veli Karaça, anëtar i kuvendit- paraqiti dy vërejtje në dy diskutime të tij në faqe nr. 9 dhe 11, pasi që janë lëshuar dy gabime teknike, prandaj kërkoi që të korrigjohen.

Aprovohet në mënyrë unanime procesverbali i mbledhjes së KK-së, me vërejtjet dhe sugjerimet e R.Ramës dhe V.Karaçës.

2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë, për periudhën janar-qershori 2012.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- tha se pasi që komandanti i stacionit policor nuk është prezent në seancë, propozoi që fare të mos debatohet për të.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- tha pasi që mungon komandanti i policisë, propozoi që informata në fjalë të shtyhet për mbledhjen tjetër.

Veli Karaça, anëtar i kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, tha se arsyeva pse ka kërkuar të paraqitet kjo informatë ka qenë koha e dasmave, kur ka pas shumë krisma të pakontrolluara dhe pasi që komandanti i stacionit policor mungon dhe ka kaluar sezona e dasmave, mjafton që e kemi marrë si informatë rrëth gjendjes së sigurisë.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- tha pasi që komandanti i policisë mungon dhe ka edhe çështje tjera për të diskutuar e që nuk janë të përfshira në raport, propozoi që informata në fjalë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme, sepse çdo ditë po përballemi me çështjen e sigurisë, sidomos në komunikacion, dhe shtoi se janë disa rrugë që nuk kanë shenja të komunikacionit, ku shpejtësia zhvillohet pa kriter.

Habib Mustafa, kryesues i kuvendit- propozoi që informata në fjalë të shtyhet për mbledhjen tjetër të KK-së.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Për shkak të mospresencës së komandantit të policisë, informata në fjalë shtyhet për mbledhjen e ardhshme të KK-së.

3. Shqyrtimi i Draft-buxhetit të komunës për vitin 2013, projekteve investuese, si dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore, për periudhën 2013-2015.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-buxhetit në fjalë, tha se janë realizuar shumë takime me qytetarë, dhe pasi që janë inkorporuar 80 % të kërkeseve të qytetarëve, Grupi parlamentar i PDK-së e përkrah draft-buxhetin në fjalë.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- tha se Grupi parlamentar i LDK-së mendon se ky draft-buxhet nuk është i nivelit as për së afërmë në krahasim me pritet. Kurse lidhur me KAB-in, tha se në emër të Grupit parlamentar të LDK-së i ka paraqitur disa sugjerime të cilat janë aprovuar, mirëpo nuk janë përfillur dhe në këtë mënyrë e kanë dëmtuar kualitetin e kornizës dhe të buxhetit, dhe shtoi se pjesa tekstuale nuk përkon me atë numerike, d.m.th nuk ka një lidhje logjike dhe organike në mes të pjesëve të shkruara dhe të atyre të punuara. Mandjej duke iu referuar planifikimit të të hyrave vetanake, tha se është brengosëse pasi që shihet se nuk është punuar me një qasje serioze dhe është punuar me joprofesionalizëm, duke shtuar se ka gabime

edhe në kalkulime e që nuk guxojnë të ndodhin këto gabime në një dokument kaq të rëndësishëm, sepse kjo flet për papërgjegjësi. Ndërsa te tatimi në pronë për vitin 2012 planifikohen 230.000 €, kurse në vitin 2013 planifikohen 371.551 €, dhe në vitin 2014 zvogëlohen në 250.000 €, ndërkaq viti 2015 është identik me vitin 2014, që s'ka logjikë dhe s'ka asnjë justifikim, dhe shtoi se njëjtë është vepruar edhe tek "taksa komunale për pronësi automjeti" dhe te "taksa komunale në firmë", prandaj ky planifikim është joserioz dhe joprofesional. Lidhur me "projektet kapitale", tha se shumat nuk mund të janë kumulative, p.sh. "mirëmbajtja e rrugëve të rendit të IV-të", "gjelbërimi i hapësirave publike", "ndriçimi publik", "ndërtimi i urave". Gjithashtu tha se në bazë të projekteve të planifikuara, shihet se nuk është një ndarje e drejtë, pasi që është bërë një ndarje në baza partiake. Kurse te KAB-i (faqe nr. 3) paraqiti vërejtjen që nuk është përfshirë propozimi i tij, i cili është aprovuar nga kuvendi. Në fund në emër të Grupit parlamentar të LDK-së paraqiti këto kërkesa që të përfshihen në planifikimin buxhetor: rregullimi i rrugës rurale Vushtrri-Nadakoc-Pestovë; pastrimi dhe rregullimi i shtratit të lumit Podrançë; rregullimi i trotuarit nga pompa e deriveve të naftës deri në Bukosh; Të rritet shuma e mjeteve të ndara për rritjen e ujësjellësit në 244,000.00 €; Asfaltimi i rrugës në Maxhunaj prej varrezave deri tek lagjja "Hajdaraj"; Asfaltimi i rrugës Studime-lagjja "Sfarça-Rashica" (2013); Asfaltimi i rrugëve lokale (të deshifrohet saktë emri i rrugëve); Të deshifrohet fondi për bashkëfinancim i rrugëve në kubëza dhe trotuare (të ceket saktë për cilat rrugë është fjala, sepse kjo është dashur të saktësohet gjatë debateve nëpër bashkësi lokale); Të deshifrohet saktësisht fondi për bashkëfinancim me donatorë, sepse kështu keqpërdoret si zakonisht nga PDK-ja për votuesit e vet, duke iu shpaguar votat e goditura gjatë fushatave parazgjedhore; Të deshifrohet saktë gjelbërimi i hapësirave publike, që të mos jetë vetëm kah votuesit e PDK-së; të deshifrohet ndriçimi publik; Cilët lapidarë do të ndërtohen; Cilat ura do të ndërtohen; Të deshifrohet rregullimi i argjinaturave të lumenjve (cilët lumenj janë ata dhe cila gjatësi është ajo); Asfaltimi i rrugës lokale në Reznik të bëhet në vitin 2013 dhe në fshatin Karaçë të ndërtohet një shkollë filliore.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të AAK-së paraqiti këto propozime për t'i futur në draft-buxhet: asfaltimi i rrugës në lagjet "Sfarça dhe Rashica" për vitin 2013; Kërkoi heqjen urgjente të gypave të asbestit në qendër të qytetit, pasi që paraqesin rrezik për shëndetin e qytetarëve; Shtrimi me kubëza i rrugës "Drini i Bardhë", "Lumni Surdulli", shtruarja e rrugës në lagjen "Ferati" në fsh. Sfaraçak.

Veli Karaça, anëtar i kuvendit- tha se buxheti është akti më i rëndësishëm që aprovohet në kuvenden e komunës dhe është akt shumëdimensional. Pastaj tha se kur aprovohet buxheti, duhet menduar për të gjithë qytetarët e Komunës së Vushtrrisë, pasi që të gjithë participojnë me taksat e tyre në këto projekte, prandaj nuk është e drejtë që disa fshatra vazhdimisht të janë përfituese të projekteve, kurse disa të tjera të anashkalohen, dhe përmendi si shembull fshatin Stanoc që është i privilegjuar me investime të mëdha dhe të vazhdueshme. Mandej tha se rrugët që i ka propozuar në vitin e kaluar janë aprovuar, por nuk janë realizuar, ndër to është edhe rruga qarkore te varrezat e qytetit. Gjithashtu paraqiti vërejtje lidhur me ndërtimin e shkollave, dhe shtoi se 370.000 € janë shumë e madhe për ndërtimin e një shkolle në qytet, prandaj pyeti se a është bërë ndonjë analizë se a ka nevojë Vushtrria për një shkollë tjetër aq të madhe në qytet, kurse shuma tjetër prej 280.000 € për ndërtimin e shkollave nëpër fshatra, tha se duhet të specifikohet se në cilat fshatra ka nevojë, dhe tha se nuk duhet investuar aty ku nuk ka një arsyeshmëri ekonomike, me ç'rast kërkoi trajtim të barabartë të fshatrave, duke përmendur fshatin Karaçë, në të cilin nuk ka shkollë. Në fund tha se draft-buxheti duhet të jetë gjithëpërfshirës në përmasa të barabarta.

Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit- tha se për seancën e sotme është premtuar që secili anëtar i kuvendit do ta ketë procesverbalin nga takimet me qytetarë nëpër

bashkësitë lokale, por procesverbalin në fjalë nuk e kemi, prandaj shtoi se ka qenë e nevojshme që ta kemi, në mënyrë që të shihen kërkesat, nevojat, sugjerimet dhe vërejtjet e qytetarëve. Kurse duke iu referuar aspektit të mbrojtjes shëndetësore të nivelit primar, paraqiti vërejtje se ambulantat shëndetësore në Samadrexhë dhe Duboc janë në kontejner, kurse gjendja e ambulantës në fshatin Stroc nuk është e mirë. Prandaj në interes të qytetarëve për të marrë ndihmën e duhur mjekësore në vendin ku banojnë propozoi që të analizohen gjendja në ambulantat në fjalë, gjatë intervalit kohor 2013-2015, dhe të gjendet forma dhe mundësia që këto të shndërrohen në objekte të pranueshme për trajtim mjekësor për të gjithë pacientët. Në fund duke iu referuar rubrikës "ndihmë për shërim", tha se duhet të jetë "ndihmë apo trajtim mjekësor për personat që kanë nevojë".

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- tha se është shqetësuese që për bujqësi janë ndarë vetëm 7.000 €, duke shtuar se çështja e bujqësisë është lënë anash edhe në momentin kur nuk është formuar Drejtoria për Bujqësi. Pastaj tha se është punuar mirë në asfaltimin e rrugëve nëpër të gjitha fshatrat, edhe pse në disa raste ka investime edhe aty ku nuk ka asnje banor. Gjithashtu tha se brenda këtij viti është aprovuar propozimi që lagjja "Ferizi" të lidhet me asfaltin, por përsëri nuk është përfshirë lagjja në fjalë, kurse banorët e kanë paguar një projekt në shumë prej 700 €, prandaj kërkoi që në vitin 2013 edhe rruga në këtë lagje të asfaltohet. Mandej tha se nuk mund të asfaltohen dy kilometra rrugë lokale në fshatin Novolan me 30.000 €, kurse ka raste tjera ku rrugët janë më të shkurta, ndërsa janë të parapara 100.000-120.000 €, sepse në disa raste është punuar duke e marrë si prioritet çështjen partiake, prandaj kërkoi që në të ardhmen ndarja e mjeteve të bëhet në mënyrë proporcionale, pasi që këta banorë janë taksapaguesit. Kurse sa i përket urbanizimit të fshatrave, tha se është vepruar mirë me rregullimin e rrugëve, por duhet menduar edhe për sigurinë e qytetarëve, dhe përmendi propozimin që ka bërë qe dy vite për ndërtimin e trotuarit që lidh fshatin Bukosh me Komunën e Vushtrrisë, sepse për çdo ditë është e rrezikuar jeta e atyre qytetarëve. Në vazhdim lidhur me shëndetësinë, tha se ambulanta ka, por mungojnë doktorët në krye të detyrës, po ashtu tha se nuk mund të mbahen barërat në bodrumin e shtëpisë së shëndetit në afërsi të rëntgenit. Në fund tha se është mirë që të bëhet rajonizimi i të gjithë pacientëve, duke bërë ndarje të pacientëve edhe për nga mosha.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar tatimit në pronë, tha se në vitin 2012 planifikimi është 230.000 €, në vitin 2013 është 371.551 €, kurse në 2014 dhe 2015 është 250.000 €, prandaj kërkoi sqarim pse janë planifikuar këto ngritje dhe ulje. Po ashtu kërkoi sqarim pse ka rënje te planifikimi i inkasimit lidhur me "taksën komunale për leje ndërtimi" në mes të vitit 2012 dhe 2013, pastaj në vitet 2014 dhe 2015 ka ngritje. Gjithashtu kërkoi sqarime lidhur me "gjobat nga inspeksioni" që në 2012 janë planifikuar 30.000 €, kurse në 2013 janë planifikuar 5.000 €, ndërsa në vitin 2014 janë 25.000 €, në vitin 2015 janë 26.000 €. Në vazhdim kërkoi sqarim te: "Shfrytëzimi i pronës publike (renta)" në 2012 janë planifikuar 40.000 €, në 2013 janë 20.000 €, në 2014 janë 35.000 €, në 2014 janë 36.000 €; "Participimi në arsim" në vitin 2012 janë planifikuar 78.450 €, në vitin 2013 janë 55.000 €, në vitin 2014 janë 75.000 €, në vitin 2015 janë 76.000 €; "Inspektimet dhe matjet në terren" në vitin 2012 janë planifikuar 111.201 €, në vitin 2013 janë 72.000 €, në vitin 2014 janë 100.000 €, në vitin 2015 janë 102.000 €. Në fund kërkoi që të saktësohet nëpër vite se ku do të ndërtohen fusha sportive në fshatra.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-buxhetit në fjalë, tha se shumë gjëra janë të pakonkretizuara, prandaj duhet të konkretizohen: objektet sportive, projektet e ambientit dhe në të gjitha lëmitë tjera. Kurse lidhur me ndarjen e mjeteve nga të hyrat vetanake, tha se është një parim që nuk po zbatohet, sepse tatimi në pronë i kthehet atij që paguan. Pastaj tha se duhet të ketë kualitet në asfaltimin e rrugëve. Në vazhdim tha se duhet të precizohen rrugët me kubëza në

qytet, kanalizimet, trotuaret, prandaj duhet të jetë lista për to e precizuar dhe e bashkëngjitur, në mënyrë që të mos mbetet në mëshirën e individit të caktuar. Mandej tha se buxheti në fjalë e stagnon zhvillimin e Komunës së Vushtrrisë, pasi që ka rënie të investimeve kapitale. Gjithashtu tha se është obligim institucional që qytetarët të trajtohen në mënyrë të barabartë, dhe shtoi se në fshatin Stanoc i Ulët ka raste që vetëm një shtëpie (në ara) iu është asfaltuar rruga, kurse lagjet "Duraku dhe Krasniqi" akoma nuk kanë rrugë të asfaltuar, prandaj apeloi që bashkërisht të ngritemi mbi interesat e ngushta partiake, në mënyrë që të krijohen parakushte për një zhvillim më të qëndrueshëm për një përmirësim të jetës së qytetarëve.

Vlora Qirezi, anëtar e kuvendit- duke iu referuar shumës së ndarë prej 25.000 € për bursa për studentë, në emër të Grupit parlamentar të LDK-së propozoi që për këtë vit të rritet shuma në 50.000 €, pasi që në vitin e kaluar nuk janë ndarë fare bursa për studentë.

Ferit Idrizi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-buxhetit në fjalë, tha se është dashtë të definohen me kohë projektet, dhe gjatë një viti kalendarik të identifikohen nevojat. Gjithashtu tha se është dashtë të jenë të definuara rrugët me kubëza, lapidarët, trotuarët dhe ndriçimi, prandaj propozoi si bruto-buxhet të aprovohet, kurse për mbledhjen tjetër të KK-së të vjen në formë të propozim-vendimit dhe të detajizohen: rrugët me kubëza, lapidarët, trotuarët dhe ndriçimi, duke propozuar që të përfshihen edhe propozimet e paraqitura nga përfaqësuesit e subjekteve tjera politike.

Bahrije Pllana, anëtar e kuvendit- tha se edhe në KPF ka kërkuar që anëtarëve të kuvendit t'i dorëzohen procesverbalet nga të gjitha takimet nga dëgjimet buxhetore të mbajtura në terren, me qëllim që kërkesat e qytetarëve të jenë sa më transparente dhe të merren parasysh. Gjithashtu propozoi që në prioritet të investime kapitale të hyjnë: ndërtimi i rrugës Studime e Ulët-varrezat e qytetit, renovimi i disa shkollave, sidomos në ato shkolla që dyshemetë janë në dërrasa, dhe shtoi se është urgjente të ndërohen dyshemetë në këto shkolla, pasi që dërrasat lyhen me një materie që është kanceroze. Kurse tek subvencionet, propozoi që t'i ndahet një shumë e të hollave asamblesë së fëmijëve të Komunës së Vushtrrisë, po ashtu propozoi që Grupit të grave asambleiste t'i ndahen 10.000 €.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- tha se draft-buxheti komunal për vitin 2013-2015 është hartuar konform Kornizës buxhetore si dhe qarkores buxhetore 01/2013 dhe 02/2013, kurse në bazë të Qarkores buxhetore 01/2013 kanë qenë 8 hapa të veprimit, dhe hapi i 8-të ka qenë aprovimi i buxhetit i propozuar nga kuvendi i komunës, pastaj dorëzimi në Ministrinë e Financave. Mandej njoftoi se ka mbajtur dëgjime buxhetore, kurse janë realizuar 11 takime me qytetarë, 9 takime nëpër bashkësi lokale (fshatra) dhe 2 takime në qytet. Në vazhdim duke iu referuar vërejtjeve nga anëtarët e kuvendit lidhur me planifikimet e të hyrave vetanake, tha se ky është vetëm një plan, por në momentin që realizohen të hyrat, me vendim të kuvendit mund të rriten të hyrat vetanake. Në fund paraqiti sqarime shtesë lidhur me draft-buxhetin në fjalë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- fillimisht falënderoi USAID-in për ndihmë në sugjerime rreth hartimit të Kornizës buxhetore, dhe shtoi se është bërë një planifikim real buxhetor dhe gjithëpërfshirës. Pastaj duke iu referuar vërejtjeve dhe sugjerimeve të anëtarëve të kuvendit, tha se prej 66 fshatrave që ka Komuna e Vushtrrisë, vetëm në 6 fshatra nuk kemi mundur t'i kriojmë asfalt deri te fshati, kurse në shumë fshatra dhe në qytet kemi ndërtuar edhe rrugë lokale, megjithëse ka akoma rrugë lokale që duhet ndërtuar në qytet dhe fshatra. Kurse lidhur me investimet kapitale, tha se është më pak se sa vitin e kaluar, por rikujtoi se vitin e kaluar ka pas shumë pak mallra dhe shërbime. Mandej tha se rruga Nadakoc-Pestovë nuk mund të realizohet në vitin 2013, dhe shtoi se për ndërtimin e rrugës në fjalë duhet të bëhen edhe shpronësime. Gjithashtu u pajtua që është i nevojshëm

rregullimi i lumit "Podrança", por për këtë duhet të ketë të holla. Ndërsa përrregullimin e trotuarit nga pompa e derivateve të naftës deri në fshatin Bukosh, njoftoi se para disa ditësh ka realizuar takim në Drejtorinë e Rrugëve (në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës) dhe ata janë duke bërë përpjekje maksimale që në këtë vit ta ndërtojnë trotuarin në fjalë, po ashtu njoftoi se do të ndërtohet një rrreth në rrugën "Ismail Qemajli", si dhe do të vendosen semaforë në udhëkryqin e rrugës "2 Maji"; Të dyja anët do të lidhet ura e Preluzhës me asfalt; Do të riasfaltohen 800 metra në rrugën e Samadrexhës dhe rrreth 500 metra në rrugën Vushtrri-Druar-Gllavotin. Ndërkaq lidhur me shtrimin e rrugëve në kubëza, tha se rragët në kubëza do të shtrohen ato rragë për të cilat qytetarët participojnë më shumë dhe më shpejt. Në vazhdim tha se çdo vendim që e nxjerr kuvendi i komunës duhet të ketë mbulesë financiare. Pastaj tha se është e rëndësishme të ngritët një lapidar për familjen Konjuhi. Kurse lidhur me emërtimin e hapësirave që do të gjelbërohen, propozoi që të mos procedohen në të ardhmen, pa e prezantuar në kuvend listën e projekteve se cilat hapësira të qytetit do të gjelbërohen, duke kërkuar që e njëjtë procedurë të respektohet edhe lidhur me ndriçimin publik. Duke iu referuar propozimit për ndërtimin e shkollës fillore në fshatin Karaçë, tha se nuk ka mësim cilësor me klasë të kombinuara, prandaj më së miri është që për ata nxënës të organizohet transport i rregullt në shkollën "Andon Zako Çajupi", kurse kërkësës për ndërtimin e rrugës "Drini i Bardhë", u përgjigj se ajo është rragë lokale, dhe propozoi që banorët e rrugës në fjalë të participojnë dhe do të ndërtohet rruga e tyre, po ashtu për rrugën "Lumni Surdulli" propozoi që të realizohet përmes participimit. Gjithashtu njoftoi se ka filluar realizimi i projektit për ndërrimin e gypave të asbestit në qytet, duke shtuar se është projekt trevjeçar, kurse në procedim e sipër është shtrimi i rragës në zhavorr prej Cecelisë deri në Kunovik. Në vazhdim kërkoi që të hartohet procesverbali për të gjitha takimet e dëgjimeve publike buxhetore dhe t'i dorëzohet të gjithë anëtarëve të kuvendit. Në fund lidhur me taksën në firmë, tha se është sugjerim edhe i ekspertëve ndërkombëtarë që në të ardhmen të hiqet taksa në firmë.

Safet Idrizi, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale- duke iu referuar vërejtjes së S.Kadriut lidhur me rrezatimin e barërave në shtëpinë e shëndetit, tha se vendi ku bëhen fotografimet është i izoluar me plumb, dhe nuk ka gjasa teorike të ketë rrezatim të barërave. Ndërsa lidhur me kërkësën e P.Pllanës për ndërtimin e ambulantave në fshatin Samadrexhë dhe Duboc, tha se nuk kanë mundur të ndajnë mjete për investime kapitale nga granti specifik i shëndetësisë, por premtoi se shumë shpejt do të ndërmerrret diçka në këtë drejtim. Në fund tha se është duke u punuar në drejtim të zonimit të pacientëve.

Veli Karaça, anëtar i kuvendit- duke iu referuar aktiviteteve të parapara në Qarkoren buxhetore, tha se është anashkaluar një aktivitet që ka qenë i paraparë deri më 01.09.2012, prandaj sikur të ishte shqyrtuar draft-buxheti deri më 01.09.2012, nuk do të vinte kjo situatë që tanë të aprovohet buxheti, e më vonë të definohen projektit. Pastaj lidhur me arsyetimet e paraqitura nga drejtori i DBF-së për çështjen e planit dhe realizimit të tij, tha se plani që nuk mund të realizohet, nuk është plan, pasi që plani duhet të jetë i realizueshëm, dhe shtoi se kur të përcaktohen projektit prioritare, ato duhet të bazohen në burime të sigurta financiare. Në vazhdim duke iu referuar shumës prej 280.000 € për ndërtimin e shkollave nëpër fshatra, tha se ka nevojë të definohen se në cilat fshatra duhet të ndërtohen, dhe përmendi çështjen e shkollës në fshatin Karaçë, duke u pajtuar që nxënësve të fshatit në fjalë duhet t'u ofrohet mësim cilësor, dhe nëse nuk mund t'i ofrohet mësimi cilësor në fshat, atëherë të transportohen në qytet, por ata nxënës as nuk po transportohen dhe as nuk kanë shkollë të re. Në fund, lidhur me projektit që realizohen me fazë, tha se janë projekte që nuk i plotësojnë nevojat e qytetarëve,

prandaj më mirë është që në vend të tyre, të planifikohet realizimi i ndonjë projekti të vogël.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar lapidarëve, propozoi që t'i ndërtohet një lapidar edhe Hys Popovës. Pastaj tha se nuk pajtohet me propozimin e kryetarit që vetëm për tri shkolla të organizohet transporti i nxënësve, pasi që ka me dhjetëra shkolla "xhuxhe". Në fund tha se është e nevojshme të futet në prioritet për realizim rruga te varrezat (lagjet "Rashica dhe Sfarça"), pasi që është bërë projekti. **Hajrulla Muli, anëtar i kuvendit-** tha se në fshatin Kunovik jetojnë 12 familje, dhe shtoi se është e nevojshme të ndërtohet rruga në fshatin në fjalë, pasi që është i vetmi fshat që ka mbet pa asnje rrugë.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- duke iu referuar asaj që e ka thënë më herët për draft-buxhetin në emër të Grupit parlamentar të LDK-së, e që propozimet e tyre nuk po përfillen, shtoi se ky buxhet nuk është punuar në mënyrë profesionale, pasi që ka shumë lëshime, prandaj ky buxhet nuk ofron përmirësim të ambientit ndërmarrës në Komunën e Vushtrrisë, as sjellje të investitorëve, si dhe nuk siguron qëndrueshmëri të zhvillimit ekonomik, dhe për këto arsyen Grupi parlamentar i LDK-së nuk do ta votoj draft-buxhetin në fjalë.

Pajazit Plana, anëtar i kuvendit- lidhur me çështjen e ngritur nga S.Kadriu për rrezatimin e barërave, propozoi që të kërkohet një raport profesional nga shërbimi radiologjik dhe i njëjtë t'i dorëzohet anëtarëve të kuvendit. Pastaj tha se kur kanë qenë në bashkësinë lokale në Pantinë (në cilësinë e anëtarit të KPF-së) kemi propozuar që "Kulla e Begut" të përgatitet për 100-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, si objekt relikt.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- tha se pajtohet që të aprovohet buxheti në tërësi me shumën e paraparë, kurse çështjet tjera të definohen në një mbledhje tjetër të KK-së.

Habib Mustafa, kryesues i kuvendit- propozoi që të votohet draft-buxheti në fjalë duke inkorporuar propozimet e kryetarit të komunës që tri projektet e përgjithësuara: gjelbërimi i hapësirës publike, ndriçimi dhe sinjalizimi horizontal dhe vertikal të procedohen në kuvendin e komunës për ta aprovuar listën finale.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 17 vota "për", 7 "kundër", 7 "abstenim" vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim aprovohet buxheti i Komunës së Vushtrrisë, KAB-i dhe lista e projekteve prioritare për vitin 2013, konform Qarkores Buxhetore 2013/02 të MEF-it, dt. 26.07.2013, e që janë pjesë e këtij vendimi.

Shuma e përgjithshme e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2013 është 12,601,906.00 €, prej të cilave për:

• <i>Paga.....</i>	<i>7,280,352.00 €.</i>
• <i>Mallra dhe shërbime.....</i>	<i>1,153,560.00 €.</i>
• <i>Komunalitë.....</i>	<i>271,500.00 €.</i>
• <i>Subvencione.....</i>	<i>155,000.00 €.</i>
• <i>Shpenzime kapitale.....</i>	<i>3,741,494.00 €.</i>
<i>Githsejt:.....</i>	<i>12,601,906.00 €.</i>

4. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, për vitin 2013 (Shqyrtimi i dytë).

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se gjatë shqyrtimit të parë në emër të Grupit parlamentar të LDK-së ka propozuar që (te neni 6) të bëhen ndryshime te norma e tatimit, dhe përmendi si shembull "pronën

komerciale” që është norma tatinore e njëjtë me “pronën e pameremetuar dhe jo të gatshme komerciale”, e që për këtë të fundit ka propozuar që të zvogëlohet, pasi që as vlera e asaj prone nuk është e njëjtë. Pastaj te neni 8, tha se mënyra e ndarjes së zonave është e njëjtë që nga viti 2002, prandaj në mbledhjen e kaluar të KK-së propozimi ka qenë që zona e parë të ndahet në dy nënzonë, kurse në zonën e tretë duhet të cekën rrugët me emra, ndërkaq duke iu referuar zonës së katërt, tha se gjendja ka ndryshuar, pasi që nuk është vlera e pasurisë së një shtëpie në Shalë me atë në Stanoc, Smrekonicë apo Bukosh, prandaj është dashtë të emërtohen me emra cilat fshatra hyjnë në zonën e katërt. Në vazhdim tha se këto ndryshime janë të domosdoshme, pasi që po ngarkohen me tatin në pronë me tepër ata të cilët kanë pasuri më pak, kurse po investohet atje ku edhe vet qytetari ka mundësi të investoj me mjete të veta. Në fund tha në emër të Grupit parlamentar të LDK-së nuk do ta votojnë draft-rregulloren në fjalë, pasi që asnje nga vërejtjet nuk është inkorporuar, duke shtuar se nuk është duke u punuar siç duhet askund lidhur me ngarkesën në tatin në pronë, për pronë në etazhe, pasi që vlera e banesave nuk është e njëjtë si në katin e parë, si në katin e dhjetë.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- lidhur me draft-rregulloren në fjalë, tha se edhe me Qarkoren buxhetore është e paraparë se çka duhet të ndryshohet në këtë rregullore, dhe shtoi se zakonisht është harmonizuar me ligjet në fuqi. Kurse te caktimi i zonave, tha se është e vërtetë që kërkohet punë më shumë për caktimin e tyre.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke iu referuar propozimeve të I.Gashit, tha se pajtohet që zona e parë duhet të pësoj ndryshime, prandaj propozoi që zona e parë ta përfshin rrugën “Dëshmorët e Kombit” duke filluar nga gjimnazi deri te Akademia Politeknicë, kurse pjesa tjeter të mbetet në zonën e dytë, kurse zonat tjera të mbisin ashtu siç janë paraqitur në draft-rregulloren në fjalë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se kuvendi i komunës për çdo vit aprovon rregullore për vitin vijues rrëth çështjes së tatimit në pronën e paluajtshme. Në vazhdim i propozoi kryetarit të komunës që të verifikohet gjendja e pronave sipas vendimeve dhe gjendjes në terren, pasi që është edhe obligim ligjor që 1/3 ta vërteton sipërfaqen e ngarkuar me tatin, dhe shtoi se ka sipërfaqe shumë më të vogla të tatuara, se sa gjendja reale në terren, prandaj kërkoi që të bëhet verifikimi i gjendjes reale nga një komision “Ad hoc”.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 22 vota “për”, 8 “kundër”, të tjerët “abstenim” vendosi me sa vijon:

Aprovohet Rregullorja për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, për vitin 2013, duke inkorporuar edhe vërejtjet e anëtarëve të kuvendit.

5. Shqyrtimi i Informatës përfundimin e vitit shkollor 2011/2012 dhe përgatitjet për vitin shkollor 2012/2013.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, në emër të Grupit parlamentar të LDK-së, tha se kjo informatë është jashtëzakonisht e mangët, pasi që mungojnë të dhënat në lidhje me fillimin e vitit shkollor 2011/2012, ku do të përfshihen të dhënat: si ka filluar viti shkollor, a ka pas pengesa, nuk ka të dhëna për orët e humbura mësimore, nëse ka munguar ngrohja në ndonjë shkollë, nëse ka pas orë të humbura nga mësimdhënësit apo nga nxënësit, pse ka ardhur deri te kjo, të paraqitet e dhëna se me çfarë kuadri arsimor ka filluar viti shkollor 2011/2012, sa nxënës e kanë vjuar vitin shkollor 2011/2012, cila ka qenë shkolla më e suksesshme, por edhe më e pastërtë gjatë vitit shkollor 2011/2012, cili ka qenë drejtori më i suksesshëm, të paraqitej e dhëna që do të duhej të realizohej gjatë vitit dhe të

shpallet nxënësi më i mirë, por edhe mësimdhënësi më i mirë. Pastaj pyeti se çka është ndërmarrë në përmirësimin e cilësisë së mësimit në shkollat e Komunës së Vushtrrisë, prandaj edhe për këtë çështje do të duhej të informohet kuvendi i komunës. Në vazhdim përmendi premtimin e vitit 2010 në kuvendin e komunës (të drejtoreve të Drejtorisë për Arsim) se asnjë shkollë në vitin 2011 nuk do të fillojë pa qenë e emërtuar, kurse sot akoma disa (5-6) shkolla janë të paemërtuara, dhe përmendi shkollën në fshatin Dobërllukë e cila është emërtuar "Latif Berisha", por që akoma figuron mbishkrimi me emrin e donatorit nga Emiratet e Bashkuara Arabe. Kurse lidhur me suksesin e nxënësve, tha se pothuajse në të gjitha shkollat tejkalohet 90 %-shi, ndërkaq në testime të maturës rezultatet janë nën 50 %, dhe shtoi se është e nevojshme që të paraqitet (në informatën në fjalë) kriteriumi rrëth notimit në shkolla. Mandej lidhur me përgatitjet për vitin shkollor 2012/2013, tha se edhe kjo pjesë e informatës ka shumë mangësi, sepse është dashtë të informohemi se a ka filluar procesi mësimor në të gjitha shkollat, a ka furnizim në të gjitha shkollat, nëse jo, pse nuk ka, dhe a është në procedurë çështja e furnizimit. Në fund tha se askund në informatë nuk përmenden depot për vendosjen e lëndëve djegëse, duke shtuar se në disa shkolla mungojnë depot e tilla.

Xhemajl Pllana, anëtar i kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, tha se është paraqitur një sukses i dëshirueshëm, por shprehu dyshimet e tij në lidhje me vërtetësinë e këtij suksesi. Kurse lidhur me përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor, tha se në bazë të informatave që ka, në gjimnaz ende nuk mbahet mësimi në lëndën e biologjisë, përkundër asaj se Vushtrria ka kuadro të mjafueshëm të kualifikuar të kësaj lënde. Po ashtu në informatë thuhet se shkollat janë furnizuar me thëngjill, kurse sipas informatave të tij, KEK-u qe një javë ka filluar të furnizoje me thëngjill për ngrohje, prandaj pyeti drejtorin e arsimit nga është furnizuar me thëngjill? Gjithashtu tha se ka informata që në shkollën e mesme profesionale "Bahri Haxha" ka pasur një donacion rrëth 700.000 € (nga DANIDA daneze) për meremetimin e shkollës dhe për mjetet tjera të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor teorik dhe praktik për nxënësit e kësaj shkolle, mirëpo realizimi praktik i këtyre investimeve nuk e arsyeton shumën prej 700.000 €, dhe shtoi se mjetet e shpenzuara nga ky donacion nuk tregojnë se janë shpenzuar më tepër se 350.000 €, kurse nga i njëjti donator ka përfituar material ndërtimor edhe drejtori i kësaj shkolle për ndërtimin e shtëpisë së vet, prandaj kërkoi auditim të mirëfilltë dhe profesional me qëllim të eliminimit të dyshimeve rrëth keqpërdorimeve, në mënyrë që të ndikohet pozivisht në përfimitin e donacioneve për Komunën e Vushtrrisë.

Habibe Gérxhaliu, anëtare e kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, tha se është shqetësues suksesi i nxënësve në klasët e kombinuara, prandaj propozoi që me klasët e II-ta të punohet dy orë, kurse me klasët e IV-ta tri orë ndarazi.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- tha se informata në fjalë nuk është e plotë dhe ka mungesa të shumta, duke filluar nga mungesa e regjistrimit përfundimtar në klasën e parë në shkollat fillore, si dhe klasën e X-të në shkollat e mesme të larta. Gjithashtu tha se a është paradoksale të kemi vetëm profilin e gjimnazit, dhe shtoi se 17 klasë janë me nxënës në gjimnaz, prandaj pyeti ku janë shkollat profesionale dhe teknike, prandaj kjo po krijon edhe diferenca në suksesin e nxënësve. Pastaj tha se do të duhej të kishte informatë se a kontrollohen shkollat, qoftë nga niveli ministrit apo lokal. Mandej tha se pse të bëhet ekspertimi i arritshmërisë vetëm në tri shkolla, kur dihet se nuk janë vetëm këto tri shkolla. Në fund kërkoi informatë për çështjen e praktikës, pasi që nxënësit nuk e bëjnë praktikën sa duhet dhe si duhet.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, tha se në vend të saj është dashtë ta kemi në raport, sepse më 31 gusht ka përfunduar viti shkollor, ka filluar viti tjeter dhe anëtarët e kuvendit nuk kanë pasur raport lidhur me gjendjen, sidomos lidhur me testin e maturës të mbajtur në afatin e qershorit. Pastaj tha se në informatën në fjalë është dashtë të pasqyrohet gjendja për secilën shkollë

veçmas në afatin e qershorit nga testi i maturës, pasi që kulminacioni i gjithë punës dhe aktivitetit nëpër shkolla të mesme, është testi i maturës. Në vazhdim tha se edhe vitin e kaluar ka qenë kundër mësimit në paralele të kombinuara, pasi që mësimi i kombinuar nëpër klasë me vite të ndryshme nuk ka dhënë dhe nuk do të jep rezultate, prandaj më mirë do të ishte të barten ata nxënës nëpër shkolla ku mbahet procesi i rregullt i mësimit. Mandej tha se është shqetësuese kur disa prind e kanë paraqitur çështjen e furnizimit me libra për nxënësit e shkollave për klasët I-V, kur dihet se grantet qeveritare janë ndarë për këtë kategori nxënësish. Ndërkaq lidhur me tabelat e paraqitura në informatën në fjalë, tha se ka kërkuar që të jenë të dhënë lidhur me secilën shkollë të mesme veçmas se si ka qenë gjendja në afatin e qershorit në testin e maturës, dhe në një tabelë tjetër të paraqitet gjendja e afatit të gushtit, pasi që në bazë të disa informatave në afatin e qershorit ka qenë një debakël në shkollën e mesme profesionale, sepse është numri shumë i vogël i nxënësve që kanë kaluar testin e maturës, dhe si rezultat i kësaj gjendjeje të keqe (edhe përkundër donacioneve të mëdha) duhet menduar çfarë duhet të bëhet për t'i kthyer suksesin shkollës së mesme teknike dhe profesionale, duke shtuar se edhe gjimnazi ka shënuar rënien në afatin e qershorit. Po ashtu paraqiti vërejte lidhur me procedurat e pranimit të punëtorëve të arsimit dhe thuhet se edhe përfaqësuesi i Ombudsperosnit (nga Mitrovica) ka ardhur në Vushtrri, pasi që ka pasur ankesa të mëdha, dhe përmendi një rast kur në gjimnaz nuk pranohet profesori me fakultetin e kryer 4-vjeçar, por pranohet tjetri me baçelor 3-vjeçar, kurse në shkollën teknike (edhe në vitin e kaluar edhe sivjet) nuk janë pranuar inxhinierët e diplomuar, për këtë arsyen çështja e respektimit të konkursit duhet të jetë prioritet i Drejtorisë për Arsim. Në fund tha se disa transportues të nxënësve nëpër shkolla janë ankuar se komuna iu ka mbetur borxh për disa muaj, prandaj propozoi që paraprakisht komuna të lidhë kontratë me transportuesit e nxënësve.

Xhyllsimi Feka, anëtarë e kuvendit- tha se informata në fjalë ka mangësi dhe është e shkurtë në krahasim me problematikën me të cilën ballafaqohet arsimi në Komunën e Vushtrrisë. Pastaj tha se prej vitit të vitit ka përmirësime në krijimin e kushteve për zhvillimin e mësimit, por është çështje tjetër pse këto kushte nuk po ndikojnë në ngritjen e rezultateve të mësimit, por shtoi se teknikisht kanë qenë të mira përgatitjet përmes mbajtjen e testit të maturës, kurse si mangësi e përmendi faktin se hartimi i testeve nuk ka qenë në nivelin e duhur, sepse testohen drejtimet e ndryshme me të njëjtin test. Mandej tha se është brengosëse që vite me radhë ballafaqohemi me probleme të njëjta, siç është pirja e duhanit nëpër shkolla. Gjithashtu përmendi edhe çështjen e transportit të nxënësve, dhe shtoi se përveç distancës (nga shtëpia deri në shkollë) që e parashikon ligji, duhet të merren parasysh edhe karakteristikat e disa terreneve.

Melihate Basholli, anëtarë e kuvendit- falënderoi shoqatën "Anima" për bashkëpunimin me Drejtoren e Arsimit. Pastaj paraqiti vërejtje përmes Drejtoreve të shkollës "Bahri Kuqi" pasi që nuk e ka përfshirë në listë (përmes qëndrimit njëjavor në Ulqin) Lirije Kuqin, vajzën e dëshmorit Bahri Kuqi, prandaj propozoi që në vitin e ardhshëm (nëse vazhdon ky aktivitet) Lirije Kuqi të jetë në listën e këtyre nxënësve.

Qerim Selimi, drejtor i Drejtorisë për Arsim- duke iu referuar vërejtjeve të anëtarëve të kuvendit, tha se nuk ka asnjë raport zyrtar që Ombudspersoni ka qenë në vizitë në Drejtoren e Arsimit përmes marrë shënime. Pastaj u pajtua që në informatën në fjalë nuk janë përfshirë shkollat e suksesshme, niveli i pastërtisë së shkollave. Kurse lidhur me emërtimin e shkollave, tha se shkollat kanë emra që funksionojnë, si p.sh. SHMU 1, ndërsa Drejtoria përmes Arsimit i ka dorëzuar në Ministrinë e Arsimit propozimet përmes emërtimin e shkollave (të paemërtuara), pasi që Ministria e Arsimit është kompetente përmes emërtimin e shkollave, por arsyet e përmes që Arsimi është se përmes propozimeve nga Drejtoria përmes Arsimit, kanë paraqitur propozime edhe familjarë tjerë. Ndërkaq duke iu referuar

vërejtjes së M.Bashollit, tha se shoqata "ANIMA" ka organizuar një ndejë në Ulqin për nxënësit që janë familje të dëshmorëve dhe që janë me gjendje të rëndë sociale, dhe rastet e tilla i kanë përzgjedhur drejtorët e shkollave, ndërsa drejtori i apostrofuar ndoshta është një ndër drejtorët më të mirë i njërsës ndër shkollat më të mira të komunës. Në vazhdim njoftoi se shkollat janë furnizuar me lëndë djegëse, ndërsa me thëngjill janë furnizuar nga një kompani, e cila është përzgjedhur nga operatori përmes të gjitha procedurave të prokurimit. Ndërkaq lidhur me konkursin pér lëndën e biologjisë, tha se konkursi akoma është i hapur, kurse mësimi mbahet nga profesorët që janë në kuadër të gjimnazit. Ndërsa lidhur me donacionin e DANIDA-s, tha se këtë donacion e ka menaxhuar zyra e DANIDA-s që gjendet në Prishtinë. Kurse lidhur me mësimin në klasët e kombinuara, tha se në vitin e kaluar (me propozimin nga Drejtoria pér Arsim) është marrë vendim nga kuvendi i komunës që të myllen tri shkolla që kanë mbajtur mësim me klasë të kombinuara. Mandej tha se në klasët e X-ta në gjimnaz janë regjistruar të gjithë nxënësit që i kanë plotësuar kriteret sipas Ministrisë së Arsimit me suksesin shkollor, e jo me testin e arritshmërisë, ndërsa 1220 nxënës janë regjistruar në klasën e I-rë. Ndërkaq tha se në informatën e muajit korrik (pér kuvendin e komunës) ka paraqitur edhe tabelat që flasin pér rezultatin e testit të maturës pér secilin drejtim. Në fund, sa i përket borxhit ndaj kombibusëve, tha se disa kombibusë kanë transportuar nxënës (përmes një premtimi verbal), ndërkohë kuvendi i komunës ka marrë vendim që atyre njerëzve t'iu paguhet ai borxh, por është bllokuar pasi që nuk po lejohet të paguhet në mënyrë retroaktive, dhe shtoi se sivjet prej këtij shtatori, Drejtoria pér Arsim nuk paguan transportin e organizuar të nxënësve, pér shkak të mungesës së mjeteve financiare.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- pyeti drejtorin e arsimit se a ka menduar Drejtoria pér Arsim lidhur me problemin e peshës së librave që nxënësit e shkollës fillore po i bartin në shpinat e tyre?

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- duke iu referuar fjalimit të drejtorit të arsimit, tha se drejtori nuk iu ka përgjigjur në pyetjen rrëth furnizimit me libra pér klasët I-V.

Qerim Selimi, drejtor i Drejtorisë pér Arsim- duke iu referuar pyetjes së B.Jasharit, tha se pesha e librave do të zgjidhet kur procesi mësimor do të zhvillohet vetëm në një ndërrim. Kurse lidhur me pyetjen e S.Kadriut, tha se është e vetmja Komuna e Vushtrrisë në nivelin e Republikës së Kosovës që në këtë vit tekstet shkollore i ka marrë të plota pér klasët I-V, ndërsa pér klasët VI-IX nuk është marrë asnjë tekst, por janë shfrytëzuar tekstet e vjetra.

Xhemajl Pllana, anëtar i kuvendit- tha se nga drejtori ka kërkuar përgjigje pse nuk është shpallur konkursi në kohën e rregullt, prandaj kjo është shkelje e procedurës, pasi që punëtori në fjalë është pensionuar nga fundi i muajit prill. Kurse sa i përket kompanisë, tha se kur të përzgjedhet kompania, është komisioni i cili e verifikon se a është kompania e licencuar, çfarë performance ka pas dhe nga e ka sjell thëngjillin, prandaj tha se kërkoi që të informohet se nga e ka sjellë thëngjillin.

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit pér shpalljen e konkursit pér anëtarësim në komitetet konsultative.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- kërkoi që të respektohet nen 9 i Udhëzimit Administrativ, në të cilin është thirr propozuesi, ku kërkohet që 1/3 e anëtarëve të komiteteve fakultative të ndërrohen çdo vit.

Haki Maloku, përgjegjës i sekretarisë- sqaroi se të gjithë anëtarëve të komiteteve konsultative në shtator të këtij viti iu ka skaduar mandati.

Xhyllsimë Feka, anëtare e kuvendit- propozoi që në kuadër të konkursit pér komitetet konsultative, të formohet dhe të shpallet konkursi edhe pér Komitetin Konsultativ pér të Drejtat e Njeriut dhe pér Barazi Gjinore.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim shpallet konkursi për anëtarësim në këto Komitete Konsultative të KK-së:

- *Komiteti për Arsim, Kulturë, Fe, Sport dhe Rini (7 anëtarë);*
- *Komiteti për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike (7 anëtarë);*
- *Komiteti për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit (7 anëtarë);*
- *Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale (7 anëtarë);*
- *Komiteti për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore (7 anëtarë).*

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve buxhetore të komunës.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim bëhet ridestinimi i mjeteve nga fondi 10 nga kategoria e investimeve kapitale (programi 664250, Planifikimi Urban dhe Mjedis), nga këto projekte:

Kodi i projektit 86182, Asfaltimi i rrugëve në fshatin Bivolak, shuma e projektit 60,000.00 €.

Kodi i projektit 86180, Asfaltimi i rrugës në fshatin Dumnicë e Epërme, shuma e projektit 95,612.00 €.

Nga fondi 22 nga kategoria e investimeve kapitale, (programi 644250, Planifikimi Urban dhe Mjedis), kodi i projektit 83137 Pranimi teknik i projekteve, shuma 7,500.00 €.

Nga projektet e cekura ridestinoohen mjetet në shumën 14,653.75 €, në të njëjtin program buxhetor, në këto projekte:

- *Asfaltimi i rrugës Prelluzhë, kodi i projektit 86181 në vlerë 7,653.75 €.*
- *Asfaltimi i rr.Kollë-Bruznik, kodi i projektit 86169 shuma 500.00 €.*
- *Ndërtimi i urës dhe zgjerimi i rrugës në f.sh Pantinë në vlerë 6,500.00 €.*

8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit nr. 39/10, të datës 25.02.2010.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi i kuvendit të komunës 01 Nr. 39/10 i datës 25.02.2010, ku anëtarin e deritashëm të komisionit, Murteza Dallkun, e zëvendëson Izet Miftari, në cilësinë e anëtarit në komisionin për intervistimin e kandidatëve për drejtorë të institucioneve edukativ-arsimore dhe aftësuese të Komunës së Vushtrrisë.

9. Të ndryshme:

a. Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë për shërim të Shehrije Feratit;

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- duke iu referuar kërkesës në fjalë, tha se 14 anëtarët e Grupit parlamentar të PDK-së u pajtuan që secili t'i jap nga 100 €.

Xhylsime Feka, anëtare e kuvendit- në emër të Grupit të grave asambleiste, tha se grupi në fjalë i ndanë 500 € për znj. Shehrije Ferati.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- propozoi që znj. Shehrije Feratit t'i ndahen 5.000 €.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- sqaroi se jemi në fazën e fundit të viti dëshmorët e Kosovës që t'i ndihmuar, dhe nëse ka një mjetë do t'i ndihmohet në këtë vit rastit në fjalë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim autorizohet Kryetari i Komunës që të angazhohet për shqyrta e kërkuesën e znj. Shehrije Ferati për t'i ndarë mjete financiare në vlerë prej 5.000 € (pesë mijë euro) për mbulimin e shpenzimeve për shërim.

b. Pyetjet eventuale të anëtarëve të kuvendit.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- tha se në dëgjimin publik të organizuar në sallën e kuvendit, përfundimisht i fshatit Sfaraçak e ka paraqitur faktin se iu është drejtuar komunës me dhjetëra kërkesa për probleme infrastrukturore në pjesën ku jeton, por nuk ka marrë asnjëherë përgjigje, prandaj pyeti kryetarin e komunës si qëndron puna në lidhje me çështjen në fjalë. Pastaj tha se në mbledhjen e kaluar të KK-së e ka bërë një propozim që të hyjë në projekte, që secila rrugë e qytetit të ketë një shenjëzim ku kryqëzohet me rrugën kryesore.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

Procesmbajtësi

Albanez Tahiraj

Lektori

Vlora Krasniqi



Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

01 Nr. 292/12
Më: 30/10 /12

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e jashtëzakonshme (e IX-të për v. 2012) e Kuvendit Komunal në Vushtrri mbajtur më 16.10.2012

Mbledhja u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar në orën 10:00.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri, përveç Ferit Idrizit dhe Vlora Qirezit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: Bajram Mulaku-kryetar i komunës, Dibrani Përçuku-nënkryetar i komunës, drejtorët e drejtive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Habib Mustafa, kryesues i Kuvendit, i cili pasi konstatoi se ka kuorum për punë, propozoi këtë:

REND DITE

- Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpalljen e delegacionit nga EBA qytetar nderi të Komunës së Vushtrrisë, në rastin e vizitës më datën 17.10.2012.

Në vazhdim, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi rendin e ditës.

- Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpalljen e delegacionit nga EBA qytetar nderi të Komunës së Vushtrrisë, me rastin e vizitës me datën 17.10.2012.

Habib Mustafa, kryesues i kuvendit - arsyetoi thirrjen e kësaj mbledhjeje të jashtëzakonshme, duke shtuar se ne kemi marrë informacione nga Ambasada e Republikës së Kosovës në EBA për vizitën e një delegacioni të lartë nga ky shtet, i cili do ta vizitojë komunën tonë më datën 17.10.2012, andaj duke qenë se kuvendi i komunës ka kompetencë ekskluzive për këtë çështje është thirrur kjo seancë e jashtëzakonshme. Në fund ai tha se kushtet ligjore nga dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit të Komunës janë përbushur, ku thuhet se seanca e jashtëzakonshme mund të thirret me kërkesën e kryetarit të komunës, andaj një

kërkesë e tillë është bërë dhe në këtë rast janë përmbushur kriteret ligjore dhe statutare pér thirrjen e kësaj seance.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit - tha se e mbështesim propozim-vendimin në fjalë pér shpalljen qytetar nderi të delegacionit të lartcekur, më tutje ai shprehu shqetësimin e ti lidhur me ndërrimin e emrit të shkollës në fshatin Dobëlluk, duke shtuar se sikur të pyetej kryetari i komunës nga ana e delegacionit në fjalë se në bazë të cilave kritere është bërë ky ndryshim? atëherë si do të përgjigjej ai. Dhe me këtë ceku se kjo nuk garanton se vendimi pér shpalljen qytetar nderi nuk do të ndryshohet në të ardhmen..

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit - tha se Emiratet e Bashkuara Arabe kanë dhënë kontribut të madh pér Kosovën në përgjithësi dhe pér komunën tonë, në veçanti në të gjitha aspektet e jetës, dhe shtoi se ne si Lëvizje pér Bashkim e përkrahim këtë iniciativë pér shpalljen e qytetar nderi të këtij delegacioni, të cilët shquhen pér një kontribut të jashtëzakonshëm pér Komunën e Vushtrrisë.

Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit - tha se delegacioni në fjalë ka dhënë një kontribut të çmuar sidomos në lëmin e shëndetësisë dhe shtoi se ky shtet ka dhënë shumë pér qytetarët tanë në përmirësimin e kushteve të banimit dhe ofrimin e shërbimeve të dinjitetshme pér qytetarët e komunës sonë, andaj dhe ceku se e mbështesim fuqishëm këtë propozim-vendim pér shpalljen qytetar nderi të këtij delegacioni. Në fund ai inkurajoi institucionet komunale pér marrjen e iniciativës pér shkëmbimin e përvojave në mes mjekëve nga Kosova dhe EBA.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit - tha se e mbështesim idenë pér shpalljen qytetar nderi të këtij delegacioni dhe shtoi se ky shtet ka dhënë kontribut të çmuar pér qytetarët e komunës sonë në shumë aspekte, duke filluar nga ndërtimi i shtëpive, shëndetësia, mandej ofrimi i ndihmës pér jetimet e mbetur nga lufta e fundit, gjithashtu në lëmin e arsimit dhe në fusha tjera.

Xhemajl Pllana, anëtar i kuvendit - tha se në emër të Lëvizjes Vetëvendosje e mbështesim këtë propozim-vendim, dhe shtoi se ky delegacion sidomos gjenerali Alkabi na u është gjendur në momente të vështira pas përfundimit të luftës sidomos në lëmin e rindërtimit dhe përmirësimin e shërbimeve shëndetësore, mandej në veshmbathje ushqim dhe në shumë aspekte tjera, dhe ceku se ky është një vendim meritор dhe e mbështesim plotësisht.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - tha se në emër të grupit parlamentar të AAK-së e mbështesim këtë propozim-vendim, dhe shtoi se këta presona, pjesë e delegacionit kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm pér qytetarët e komunës sonë në veçanti, dhe me këtë mund të thuhet se ndihmat e para qoftë në rindërtim apo në shëndetësi kanë ardhur pikërisht nga Emiratet e Bashkuara Arabe. Tutje ai shtoi se një çmim i tillë, çmimi "Qytetar nderi" është obligim nga ana jonë që t'i jepet këtij delegacioni, dhe apeloi te institucionet lokale që të kenë kujdes në reflektimin e tyre pér ruajtjen e kësaj miqësie me këtë shtet, por edhe me shtetet tjera në të ardhmen. Në fund ai propozoi që në kuadër të kësaj vizite një mirënjoje t'i ndahet ambasadorit të Republikës së Kosovës në Arabinë Saudite, i cili ka dhënë një kontribut të çmuar në këtë shtet, por edhe në vendet tjera të botës islame në paraqitjen dhe mbrojtjen e interesave të Kosovës.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit - tha se duke marrë parasysh kontributin e madh të Emirateve të Bashkuara Arabe në shumë fusha në komunën tonë, kemi obligim që të japim një çmim të tillë dhe me këtë rast në emër të grupit parlamentar të PDK-së e mbështesim plotësisht propozim-vendimin në fjalë.

Islam Krasniqi, anëtar i kuvendit - tha se Partia e Drejtësisë e mbështet fuqishëm propozim-vendimin në fjalë dhe shtoi se institucionet komunale duhet të angazhohen më tepër pér forcimin e raporteve me këtë shtet mik edhe në të ardhmen.

Besim Jashari, anëtar i Kuvendit - tha se nuk janë të tepërtë fjalët që u thanë pér këtë shtet dhe pér delegacionin e tij, të cilët kanë dhënë një kontribut të madh pér komunën tonë në shumë fusha, dhe propozoi që në këtë propozim-vendim do të

duhej që personat që do të shpallen qytetarë nderi t'ju figurojë edhe pozita të cilën e udhëheqin aktualisht.

Bajram Mulaku, kryetar i Komunës - pasi falënderoi anëtarët e kuvendit për mbështetjen e një ideje të tillë, shtoi se Emiratet e Bashkuara Arabe kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm që nga viti 1999 për refugjatët e depërtuar në Shqipëri, mandej ceku se kontributi ka vazhduar edhe pas luftës, sidomos në fushën e shëndetësisë dhe se ky shtet ka dhënë kontributin e tij edhe në rindërtimin dhe përmasimin e kushteve të banimit. Në vazhdim tha se qëllimi i kësaj vizite të këtij delegacioni është gjirimi i një filmi që i kushtohet kontributit të EBA në Kosovë, dhe në fund tha se renditja e zyrtarëve në listë për shpalljen qytetar nderi, është bërë sipas hierarkisë së caktuar nga ana e vet shtetit të Emirateve të Bashkuara Arabe dhe duke shtuar se çmimi "Qytetar nderi" është më së paku që ne mund të bëjmë si komunë për këtë delegacion, i cili ka dhënë kontribut shumë të madh.

Në fund të debatit lidhur me pikën në fjalë, të rendit të ditës, kuvendi vendos me sa vijon:

Me këtë vendim, në shenjë respekti dhe nderimi të delegacionit më të lartë shtetëror të Emirateve të Bashkuara Arabe, në rastin e vizitës në Komunën e Vushtrrisë më 17 tetor 2012, Kuvendi Komunal i Vushtrrisë shpall qytetarë nderi:

- Ali Mohammed Subaih Alkaabi (gjeneral në EBA)
- Shaikh Ahmed Bin Tahnoon Alnahayan (officer në oborrin mbretëror të EBA)
- Salem Bakht Salem Alsuboosi (officer)
- Mohamed Sabeil Karam Mohamed Aldhanhani (officer)
- Aysha Sultan Mohamed Aldhaheri (officere)
- Sultan Mohamed Ali Alktedi (officer).

Në kuadër të kësaj vizite Kuvendi Komunal i Vushtrrisë, në shenjë mirënjohjeje për kontributin e dhënë, në përfaqësimin e interesave të Kosovës në botën arabe i ndan një mirënjohje dr.Rexhep Bojës - Ambasador i Republikës së Kosovës në Arabinë Saudite.

Mbledhja përfundoi në orën 10:35.

Procesmbajtësi:


Basti Duraku

Lekturoi:


Vlora Krasniqi



Kryesuesi i Kuvendit


Habib Mustafa